



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 808 Prot

Tiranë, më 15.03.2019

NJOFTIM

**Lënda:** Shpallje për vende vakante për oficerë të policisë gjyqësore

Në zbatim të nenit 38, pika 2, gërma “e”, “g” dhe “k”, të Ligjit nr.97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 10, pika 1 e Ligjit Nr. 8677, datë 02.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, i ndryshuar, shpall vendet vakante për :

1. Oficerë të policisë gjyqësore në **Prokurorinë e Përgjithshme** 10 (dhjetë) vende.
2. Oficerë të policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë **Tiranë** 3 (tre) vende.
3. Oficerë të policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë **Vlorë** 2 (dy) vende.
4. Oficerë të policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë **Durrës** 1 (një) vend.
5. Oficerë të policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë **Elbasan** 2 (dy) vende.
6. Oficerë të policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë **Fier** 1 (një) vend.
7. Oficerë të policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë **Pogradec** 1 (një) vend.
8. Oficerë të policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë **Shkodër** 3 (tre) vende.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme, sipas nenit 10, pika 1, të ligjit Nr. 8677, datë 02.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, i ndryshuar:

- të kenë përfunduar program studimi të ciklit të dytë;
- të kenë, të paktën, 4 vjet përvojë në profesion;
- të mos kenë masë disiplinore apo të mos ketë filluar ndaj tyre ecuria disiplinore;
- të mos jenë të dënuar me një vendim penal të formës së prerë apo të mos ketë filluar ndaj tyre një procedim penal;
- të kenë cilësi të larta etiko-morale.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë kërkesat së bashku me dokumentacionin që vërteton plotësimin e kritereve të përcaktuar në ligj, brënda **15** ditëve, nga data e shpalljes së njoftimit në adresën: **Prokuroria e Përgjithshme, Rruga “Qemal Stafa” Nr. 1 Tiranë.**

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

ARTA MARKU

